



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo

<http://kk.rks-gov.net/istog/>



Komuna e Istogut
Opština Istok
Municipality of Istog

Tel: 038/200 438 14

DRAFT-BUXHETI I KOMUNËS SË ISTOGUT 2026-2028

P R O C E S V E R B A L

Nga dëgjimi publik për Draft-Buxhetin e Komunës së Istogut 2026-2028 mbajtur më:
16.09.2025, në Sallën e Kuvendit Komunal, filluar me punë në ora 11:00.

Në Dëgjim ishin të pranishëm:

1. Ilir Ferati, Kryetar;
2. Drejtor të drejtorive Komunale;
3. Ardon Arifaj, Zyra e Kryetarit
4. Liliana Frrokaj, Zyra e Kryetarit;
5. Alketa Bujupaj, Zyra e Kryetarit

Mbledhja ishte e hapur dhe në mbledhje ishin të pranishëm: Kryetari i komunës, z. Ilir Ferati dhe Drejtoret e Drejtorive

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi, Kryetari i komunës, z. Ilir Ferati.

Kryetari i komunës, z. Ilir Ferati – përshëndeti të gjithë të pranishmit në këtë mbledhje dhe hapi dëgjimin publik për Draft-Buxhetin e Komunës së Istogut 2026-2028 dhe për këtë mbledhje propozoi këtë rend dite:

R E N D D I T E

1. Njoftimi për Draft-Buxhetin e Komunës së Istogut 2026-2028,
2. Pyetje dhe Përgjigje

Dëgjimi publik për Draft-Buxhetin e Komunës së Istogut për periudhën 2026-2028 u mbajt me qëllim të informimit të qytetarëve dhe mbledhjes së propozimeve lidhur me planifikimin buxhetor afatmesëm.

Takimi u hap nga drejtori për buxhet dhe financa, i cili prezantoi strukturën e draft-buxhetit, prioritetet kryesore dhe orientimet strategjike për tri vitet e ardhshme. U theksua se fokusi kryesor është zhvillimi ekonomik lokal, përmirësimi i infrastrukturës dhe rritja e cilësisë së shërbimeve publike.

Gjatë prezantimit, u shpjeguan ndarjet buxhetore për sektorë të ndryshëm, duke përfshirë arsimin, shëndetësinë, shërbimet sociale, kulturën dhe sportin. U theksua rëndësia e menaxhimit të qëndrueshëm të financave publike dhe respektimit të kufijve buxhetorë.

Qytetarët paraqitën kërkesa dhe sugjerime lidhur me rritjen e investimeve në fshatra, mbështetjen për bujqësinë, përmirësimin e rrugëve lokale dhe zgjerimin e shërbimeve sociale. U kërkuua gjithashtu që projektet kapitale të planifikohen në mënyrë më të balancuar.

Në përfundim, përfaqësuesit komunalë falënderuan pjesëmarrësit dhe theksuan se të gjitha propozimet do të shqyrtohen gjatë finalizimit të draft-buxhetit dhe para miratimit në Kuvendin Komunal.

Procesmbajtës:
Ardon Arifaj, Zyrtar për Informim dhe Monitorim të Mediave

